Tabelë e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të drejtorëve/ive, arsimit, kualifikimet e drejtuesve.

| Nr. | Drejtoria/Struktura | Detyrat funksionale | Arsimi dhe kualifikimet e drejtorëvë/CV |
|---|---|---|---|
| 1 | **DREJTORIA E LAJMEVE**<br>**Drejtor**<br>**Shef Sektori**<br>**Specialiste** | Garanton informacion për Shqipërinë dhe nga Shqipëria, ta transmetojë atë gjatë 24 orëve, duke respektuar parimet e përgjithshme gazetareske, Kodin e Etikës në Media, rregullat gramatikore të gjuhës letrare shqipe në përmbushje të misionit të ATSH-së. Të përgatisë dhe transmetojë pasqyrën e shtypit vendas.<br><br>Tꞇu ofrojë përdoruesve vendas dhe të huaj, në mënyrë të rregullt dhe pa ndërprerje, një informacion të saktë, të paanshëm dhe të besueshëm. Të mbulojë në kohë dhe saktësi dhe paanshmëri ngjarjet politike, ekonomike, sociale, kulture dhe sportive në vend dhe në të gjithë botën, falë bashkëpunimeve me agjenci homologe dhe institucione mediatike botërore. | Drejtori (CV) |
| 2 | **DREJTORIA TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT & MULTIMEDIAS**<br>**Drejtor**<br>**Specialiste** | Garanton mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit elektronik editorial dhe arkivues të lajmeve të ATSH-së si dhe të portalit të ATSH-së në internet. Mundëson krijimin e lehtësirave teknike, informatike dhe multimediale të nevojshme dhe të domosdoshme për të gjithë punonjësit në përmbushje të misionit të ATSH-së dhe përmirësimin e zhvillimin e shërbimeve të ofruara për abonentët. | Drejtori (CV) |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **3** | **DREJTORIA E FINANCES & SHERBIMEVE MBESHTETESE**<br>**Drejtor**<br>**Specialist Finance**<br>**Specialist Marketingu**<br>**Specialist Marredhenie me Jashte**<br>**Specialist Jurist**<br>**Specialist Arkiv Foto-Buletin**<br>**Specialist Arkiv/Sekretari** | Garanton mbarëvajtjen e funksionimit të të gjithë aparatit të ATSH-së, me qëllim përmbushjen e misionit, nëpërmjet koordinimit të veprimtarisë me drejtoritë e tjera dhe sektorët duke zbatuar detyrat që lidhen me përdorimin me efektivitet të burimeve njerëzore, ekonomike, financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br><br>Drejton, organizon dhe kontrollon punën për zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, me të cilat rregullohen dhe funksionojnë financat dhe burimet njerëzore te Institucionit. | Drejtori (CV) |